

## **Z. Gledis Gjipali**

### **Propozuar nga organizata Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA).**

Z.Gjipali është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2004. Në 2005 ai ka kryer një praktikë pune në Këshillin e Europës, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Politike. Ka punuar për disa vite në Ministrinë e Integritimit Europian (2004-2008), në Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit, duke mbuluar fushat e emigracionit, krimin të organizuar, bashkëpunimit gjyqësor, të drejtave të njeriut, dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Më pas në Drejtorinë e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme, u angazhua me reformën në sistemin gjyqësor e të drejtat e pronësisë. Gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesëtar i ekipeve të punës për hartimin e dokumenteve të rëndësishëm strategjik si Plani Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit, Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së, etj., si dhe pjesëtar i grupeve të punës Shqipëri – BE ku raportohet problematika dhe progresi i arritur në fusha të ndryshme.

Z. Gjipali ka përvojë të konsiderueshme në procesin e integritimit Europian, eksperiencë që e ka reflektuar fillimisht në detyrën e Drejtorit të Programeve (2008) dhe më pas të Drejtorit Ekzekutiv të EMA-s.(2009) Disa prej iniciativave më të rëndësishme të ndërmarra janë: Konventa e Integritimit Europian, një platformë bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile; Akademia e Integritimit Europian dhe Negociatave, për përgatitjen e ekspertëve nga sektorë të ndryshëm për negociatat e anëtarësimit në BE; revista EuroSpeak, një dritare informative mbi Bashkimin Europian dhe ecurinë e procesit të integritimit, etj.

Ai ka publikuar studime dhe raporte të ndryshme në fushën e integritimit europian, lëvizjes së lirë të personave, ndihmës së BE-së në zhvillimin rajonal dhe rural, sistemeve zgjedhore dhe parlamentit. Për disa vite ka qenë autori i raportit Vende në Tranzicion të Freedom House për Shqipërinë. Është anëtar i Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian si dhe i disa bordeve këshillimore të lidhura me kërkimin shkencor dhe shoqërinë civile. Z. Gjipali flet Shqip (gjuha amtare), Anglisht dhe Italisht.

## **Mr. Gledis Gjipali**

### **Proposed by the European Movement of Albania.**

Mr.Gjipali was graduated from the Faculty of Law at the University of Tirana in 2004. He has worked for several years at the Ministry of European Integration (2004-2008) at the Approximation of Legislation Directorate, addressing areas of immigration, organized crime, judicial cooperation, human rights and personal data protection. Later in the Justice and Home Affairs Department, he was engaged in the reform of the judicial system and property rights. During this period, he has been a member of the working teams for drafting important strategic documents such as the National Plan for Legislation Approximation, the National Plan for the Implementation of the MSA, etc.

Mr. Gjipali has considerable experience in the European integration process, experience that he first reflected in the position of the Program Director (2008) and later of the Executive Director of EMA (2009). Some of the most important initiatives undertaken include: the National Convention on EU Integration, a platform about the cooperation between state institutions and civil society; European Integration and Negotiation Academy, with the main focus on the preparation of experts from various sectors regarding EU accession negotiations; EuroSpeak, an informative window on the European Union and the progress of the integration process.

He has published several studies and reports in the field of European Integration, free movement of persons, EU assistance in regional and rural development, electoral systems and parliament. For several years he has been the author of Freedom House's Nations in Transit Countries Report for Albania. He is a member of the National Council of European Integration as well as in some other advisory boards related to research and civil society. Mr. Gjipali speaks Albanian (mother tongue), English and Italian.